Shaban Çupi



BUZËQESHJE LIRIE

(Poemë për Dëshmorin Gafurr Luma)

Kaçanik, 2018

Përmbledhje (ilegale) e poezive me titull "Këngët e lirisë", 1980. Këtë libër e shpërndau dëshmori Gafurr Luma



Grafikë revolucionare në gazetën "Zëri i Kosovës"



[illegible] VE DUVE, [illegible]!

LIRIA

ORGAN I MARKSISTË-LENINISTËVE TË KOSOVËS

TRAKT

VËLLEZËR DHE MOTRA,

Rrugët e Prishtinës heroike u [illegible] këto ditë përsëri në arena të përleshjeve të përgjakshme të rinisë sonë revolucionare dhe regjimit gjakatar të revizionistëve jugosllavë. Dhjetëra mijëra bijë e bija të Kosovës martire u bashkuan si një trup i vetëm dhe me grushtet ngritur lart zbrritën në fushëbetejë. Vetëm brenda dy javësh rrugët e Prishtinës u lanë dy herë me gjakun e pastër të rinisë sonë të kuqe.

Demonstratat e përgjakshme të Prishtinës, ashtu si edhe demonstratat e revoltat e shumëta anëkënd Kosovës dhe viseve tjera shqiptare, tregojnë edhe një herë se populli ynë i robëruar nuk nënshtrohet e nuk përulet as me propagandë e demagogji dhe as me dhunë e terror fashist. Ai po e kupton çdo ditë e më mirë se kush është armiku i tij i vërtetë, kush po e shtyp e shfrytëzon kaq egërsisht, kush e solli atë në këtë gjendje kaq të rëndë e të padurueshme. Ai po e kupton se edhe të drejtat dhe lirinë e tij mund t'i fitojë vetëm me luftë e sakrifica, vetëm me gjakun e tij.

Duke qenë të papërfillur nga autoritetet pushtuese e tradhtare, studentët e Universitetit të Kosovës u detyruan të dalin në demonstrata për t'i realizuar me luftë kërkesat për përmirësimin e kushteve të tyre të mjeruara të jetës dhe studimit. Por, demonstratat e tyre, studentët nuk i bënë vetëm për veten dhe hallet e tyre. Ato kishin karakter të theksuar politik, shprehnin kërkesat dhe aspiratat e të gjithë popullit, prandaj ato përkrahen nga i gjithë populli. Thirrjet dhe parullat e dhjetëra mijëra të rinive demonstrues, si: "Poshtë revizionizmi!", "Poshtë tradhtarët!" "Poshtë borgjezia!", "Hajeft shtypje e shfrytëzim!", "Deri kur ngritje çmimesh' e m[illegible] [illegible]së mallrash?", "Trepça e jone", "Kosova e kosovarëve", "Tokat shqiptare [illegible] Jugosllavi duhet të bashkohen në një njësi të vetme", "Duam republikë!", "Të burgosurit kosovarë të kthehen në Kosovë!", "Të lirohen shokët tanë", "Jemi shqiptarë dhe jo jugosllavë", "Rroftë klasa punëtore!", "Lavdi marksizëm-leninizmit!" etj., etj. që përshkonin këto demonstrata, çonin peshë zemrat e zjarrta të rinisë dhe u kallnin tmerrin armiqve dhe tradhtarëve.

Demonstratën e madhe të 26 marsit në Prishtinë rinia jonë revolucionare e organizoi pikërisht në ditën kur po hynte në Kosovë stafeta e Titos, e këtij armiku të përbetuar të popullit tonë. Armiqtë tanë revizionistë dhe hyzmeqarët e tyre "shqiptarë" shpresonin se do të shfrytëzonin [illegible] jon bajrate të stafetës për të shuar sado pak zjarrin e urrejtjes se popullit tonë kundër shtypësve e shfrytëzuesve, për të shuar ndjenjat e tij të zjarrta patriotike dhe revolucionare. Por, rinia jonë e kuqe nuk mashtrohet nga kjo paçavure. Ajo e priti atë ashtu si i ka hije: ME GRUSHT!

Ashtu si edhe herë të tjera, pushtuesit revizionistë të [illegible] dhe sahanlëpirësit e tyre në Kosovë, hoqën maskën dhe nxorrën edhe një herë [illegible] fytyrën e tyre të vërtetë fashiste. Mijëra agjentë e policë të armatosur [illegible] në dhëmbë u hodhën mbi demonstruesit trima, duke përdorur edhe gazra hel[illegible] [illegible] e mjete tjera shkatërruese. Kryerëve tradhtarë të Kosovës iu dukën pak [illegible]izëritë e agjentëve e policëve si dhe repartet e ushtrisë që ishin [illegible]

[illegible]

Trakti "Liria", i lexuar edhe nga dëshmori Gafurr Luma

Material ilegal, të cilin Gafurr Luma e ka shpërndarë

Proletarë të të gjitha vendeve dhe popuj të shtypur, bashkohuni!

LIRIA

TË MBLIDHEMI RRETH FLAMURIT FITIMTAR TË POPULLIT TONË TË BASHKUAR

Sot zbresin pa pushim në Kosovë ministra e funksionarë të larë republikanë e federativë, japin udhëzime për shtypje e represalje dhe kthehen me ngut në Beograd, për të kurdisur plane të reja antishqiptare. Gjithë aparati propagandistik jugosllav, ai i Lidhjes Komuniste, i Lidhjes Socialiste, i Lidhjes së Rinisë, mjetet të shumta informimi në Jugosllavi e Kosovë shpifin e bërtasin kundër shqiptarëve se pushoqe shqiptare, shovinistët e kanë humbur fare kokën dhe gjithë punën e kanë çuar në një qorrsokak nga i cili e kanë vështirë të dalin. Çdo masë që po ndërmarrin ata kundër shqiptarëve të revoltuar, në vend që ta qetësojë e frikësojë, po e përmaton dhe po e trimëron edhe më shumë popullin tonë të robëruar. Tani edhe vetë jugosllavët janë të bindur se, ose

KUSH NUK DERDH NJE PIKE GJAKU PER TOKE TE VET, KUSH NUK JEP ASNJE QINDAR PER TE, AI S'KA TE DREJTE AS TE VARROSET NE TE.

Sami Frashëri

Gazeta ilegale "Liria", e botuar në gjashtë numra në vitet 1980 - 1981 nga OMLK

Në vend të parathënies

Gafurr Luma u lind në vitin 1961 në fshatin Qafshqipe (Gllboshicë) të komunës së Kaçanikut. Shkollën fillore e ka kryer në fshatin e lindjes, ndërsa të mesmen në Kaçanik. I ka të kryer tri vite të studimeve në Fakultetin Elektroteknik të Prishtinës.

Për veprimtari ilegale politike nga pushteti serb-jugosllav u burgos dy herë dhe u dënua me gjithësej 10 vjet burg. Ka mbajtur burg në Gjilan, Prishtinë, Prizren, Gurakoc dhe, në fund, në burgun famëkeq të Dubravës, ku u vra në masakrën mbi të burgosurit shqiptarë në maj të vitit 1999.

Përkundër torturave të rënda që ka përjetuar, shumë shokë të tij mbetën të pazbuluar, të cilët më vonë iu bashkuan radhëve të UÇK-së.

Gafuri ishte i martuar me Hydajete Luzhën nga Begraca, komuna e Kaçanikut, me të cilën kishte dy fëmijë: Lirimin e Kaltrinën. Familja dhe shtëpia e tij ishte çerdhe lirie me vlerë kombëtare. Nëpër shtëpinë e tij dhe

nëpërmjet tij, kaluan personalitete të luftës dhe qëndresës kombëtare, si: Azem Syla, Xheladin Gashi, Nait Hasani, Bislim Zogaj, Mujë Krasniqi (dëshmor), Rexhep Selimi, Ekrem Jashari, Rexhep Bislimi (dëshmor), Hyrë Emini (dëshmore), etj. Kjo familje, pos Gafurrit, dha edhe Dëshmorin Qani Luma, kurse vëllai i tij i tretë, Emin Luma (tash i ndjerë), ishte gjithashtu luftëtar i UÇK-së.

Në 19-vjetorin e rënies dhe në 57-vjetorin e lindjes, për respekt të lavdisë së dëshmorit, po botojmë poemën "Buzëqeshje lirie".

Krahas besnikërisë, largpamësisë dhe tolerancës politike që mbizotëronte në personalitetin e tij, ishte edhe buzëqeshja e tij karakteristike, me të cilën reflektonte optimizëm lirie.

Poema "Buzëqeshje lirie" u shkrua në frymën e ngjarjeve revolucionare të vitit 1981, duke u mbështetur edhe në materialet ilegale të asaj kohe. Madje, edhe formatin e librit e bëmë sipas materialeve e broshurave ilegale, të cilat Dëshmori, jo vetëm se i lexonte, por

edhe ua shpërndante shokëve. Për të ruajtur sadopak autenticitetin e kohës, disa vargje nga shtypi ilegal i asaj kohe i bartëm brenda kësaj poeme, sepse, është e pamundur ta kërkosh Gafurrin jashtë këtij konteksti kohor.

Nga hulumtimi i veprimtarisë atdhetare të dëshmorit Gafurr Luma kemi konstatuar se ai ka vepruar në këto katër fusha:

1.Ka ngritur celula ilegale (kjo veprimtari ndëshkohej me ligjet e regjimit pushtues, sipas nenit 136 - veprimtari armiqësore),

2.Ka propaganduar idenë për Kosovën Republikë (ndëshkohej nga regjimi sipas nenit 133 - propagandë armiqësore),

3.Ka vepruar në mënyrë klandestine në përgatitjen e kryengritjes së armatosur (kjo veprimtari ndëshkohej sipas nenit 125 – terrorizëm),

4.Ka vepruar paralelisht edhe në organizimet legale politike të kohës, si në LDK, KMLDNJ dhe në Këshillin Komunal për Financim.

Gafurr Luma ka vepruar në disa celula ilegale. Nga viti 1979 ka vepruar në celulë me Ferid Qallakun. Pas rënies së Feridit në burg,

në vitin 1981, Gafurri ka vepruar në një celulë me Remzi Elezin, i cili më parë kishte vepruar me Berat Luzhën. Ka vepruar në celulë edhe me Remzi Krrabën, Bajram Dernjanin e Menduh Kaloshin. Deri më tani është argumentuar se materiale për lexim ilegal iu ka dhënë edhe Muhamet Malsiut, Kadri Imishtit, Nezir Demës, Raif Lumës, Nevait Lumës, Nejazi Lumës. Aksione konkrete në shpërndarje të pamfleteve dhe veprime të tjera konspirative ka pasur edhe me ilegalin Bexhet Luzha.

Gafurri kishte punuar ilegalisht edhe me studentë të Fakultetit Elektroteknik në Prishtinë, me Murat Gjocajn e Shefqet Halitin, nga Istogu, si dhe me Zenun Muriqin nga Peja, Avdyl Bajramin nga Vërbani dhe Zejnullah Burrnikun nga Kaçaniku.[1] Krahas tyre, Gafurri ka vepruar edhe me Ali Ahmetin e Kërçovës, derisa ka qëndruar një kohë në

[1] *Të dhënat janë marrë nga Ferid Qallaku, Remzi Krraba, Remzi Elezi, Murat Gjocaj, Bajram Dernjani, si dhe në Arkivin e Kosovës*

Zvicër.[2] Mbi të gjitha, Gafurri një lloj celule e kishte edhe brenda familjes së tij, duke filluar nga motrat e vëllezërit e deri te xhaxhai, Raifi [3] dhe farefisi.

Krahas këtyre celulave të organizuara ilegale, Gafurr Luma ka përdorur edhe metodën e agjitacionit në popull, veçanërisht te shokët e papërfshirë në organizim, duke i zgjeruar "rrathët koncentrik" të frontit të lirisë dhe të çlirimit të Atdheut.

Në aspektin ushtarak, Gafurri ishte i lidhur me komandantin e UÇK-së Azem Sylën, Ekrem Jasharin[4] dhe Bexhet Luzhën. [5] Një nga ndërlidhësit e tij ndërmjet Azem Sylës e Gafurr Lumës, pos Bexhet Luzhës, ishte edhe Isak Sherifi nga Tetova. [6] Vetëm hulumtimet më të thella dhe më të detajuara, do të nxjerrin në sipërfaqe veprimtarinë e plotë ilegale të dëshmorit Gafurr Luma.

---

[2] *Proceverbalet e UDB-së, Arkivi i Kosovës*
[3] *Informatë nga Raif Luma e Zyber Luma*
[4] *Informatë nga Ekrem Jashari,Ferizaj*
[5] *Informatë nga Bexhet Luzha, Kaçanik*
[6] *Informatë nga Isak Sherifi, Tetovë*

Gafurr Luma shpërndau shumë materiale ilegale, duke filluar nga *traktet,* që u shpërndanë ilegalisht në vitin 1979 me kryetitull: "*Lexoje, shpërndaje, armikut mos ia dorëzo*". Shpërndau revistën ilegale "*Liria*", organin "*Pararoja*", materialin "*Armiku na ka në dorë vetëm aq sa e lejojmë ne vet*", përmbledhjen me poezi ilegale "*Këngët e lirisë*", programin dhe statutin e organizatës, librin "*Titistët*", revistat ilegale "*Zëri i Kosovës*", "*Zëri i Popullit*", "*Shqipëria e Re*" e shumë literaturë e materiale tjera ilegale.

Gafurr Luma, gjatë veprimtarisë së tij politike ilegale, ishte anëtar i OMLK-së, i LPRK-së dhe i UÇK-së. Gjatë kësaj veprimtarie ka vepruar me dy emra konspirativ - pseudonime: Agimi dhe Avdiu. Pseudonimin "Agimi" e ka bartur që nga viti 1979, kurse "Avdiun" e merrë kur zgjedhet sekretar për propagandë dhe agjitacion me rastin e themelimit të Komitetit të Rrethit për

Kaçanik, më 8 nëntor 1985.[7] Komiteti i Rrethit ishte komitet lokal i organizatës ilegale "Komiteti Organizativ", në krye me, tashmë dëshmorët e kombit, Fehmi Lladrovci, Xhavit Haziri e të tjerë.

Në fushën e veprimtarisë legale, pas vitit 1990, krahas organizimit të tribunave të ndryshme politike, ai dha kontribut të çmuar edhe në LDK, KMLDNJ dhe në Këshillin Komunal për Financim.

Gafurr Luma ishte një veprimtar i orëve të para të veprimtarisë për çlirimin e atdheut. Veprimtaria e tij atdhetare ka filluar që nga viti 1979, sa ishte nxënës i shkollës së mesme në Kaçanik, në celulën ilegale me Ferid Qallakun, nga fshati Gajre, komuna e Kaçanikut, gjithashtu, i burgosur politik. Veprimtaria atdhetare e Gafurrit përfshinë një periudhë kohore 20-vjeçare dhe përfundon më 22 maj 1999, kur vritet në masakrën e regjimit

[7] *Komiteti i Rrethit për Kaçanik i Komitetit Organizativ u formua më 8 nëntor 1985 në Sllatinë të Lepencit. Në themelimin e këtij Komiteti morën pjesë Remzi Elezi, Gafurr Luma, Remzi Krraba e Bajram Dernjani*

serb mbi të burgosurit shqiptarë në Burgun e Dubravës.

Gafurr Luma është Dëshmor i luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Shkolla fillore në fshatin e tij, Qafshqipe, ku ka punuar disa vite, mbanë me krenari emrin e tij.

Gafurri ishte si *Nositi* i Lasgushit dhe si *Këmbana* e Dritëroit. Nëpër vështirësi krijohej burrëria e tij, siç thoshte Hygoi. Në kohën e gënjeshtrës e deklamonte të vërtetën dhe besonte se, edhe nëse armiku i këputë të gjitha lulet, pranverën s`mund ta ndalë, siç thoshte Neruda. Me energjinë e tij djaloshare donte të prodhonte Republikën, shtetin tonë. Ishte një idealist, por ishte realist, ishte si ajo substanca që ndryshon vazhdimisht, duke mbetur e njëjta në bërthamë. Ai synonte që, nga objekti historik, të kalonte në subjekt historibërës. Nuk pajtohej me fatin e trungut shqiptar, të shtrirë përdhe, siç thoshte Vaso Pashë Shkodrani. Ishte guri i sprovës së Hegelit. Nuk donte të kishte fatin e refugjatit të kacavarur në anijen e historisë. Ai nuk e

pranonte rolin e Kirenarit, siç thoshte Noli, por të Marathonomakut.

Gafurri e dinte se dhuna koloniale nuk ka për qëllim vetëm për t`i mbajtur në fre njerëzit e robëruar, por synonte edhe t`i dehumanizonte ata, siç thoshte Fanoni. Kahdo që udhëtonte, buzëqeshja e tij jepte shpresë e forcë, shfaqte humanizëm. E dinte se veprat e mëdha duan dashuri, përkushtim dhe pafundësi sakrificash. Herët e kishte sfiduar "lëkurën e ujkut" dhe vuajtjet ia kishin nxjerrë "lëngun e keq" nga trupi, siç thotë Shpëtim Pollozhani. I dallonte sakrilegjet dhe sakramentet dhe e kishte kuptuar thellë thënien e tribunit Sali Bajra se, ata që nuk kanë bërë punë të mira, vetëvetiu vdesin si njerëz dhe si emra. Nuk dëshironte t`i përngjante Gregor Zamzës së Kafkës, por përherë kërkonte momentin e "aktualitetit revolucionar", momentin e çlirimit. Pajtohej me Feliks Gran se të varfërit nuk janë as për t`i poshtëruar, as për t`i shfrytëzuar. Nuk i përshtatej mjedisit, nuk e donte lirinë e gaforres, por synonte, thjeshtë; të ishte

shqiptar. Gafurri nuk ikte nga vetja e tij. Ai ishte Uni, ishte bota shqiptare, një liburnë ilire që çante dallgë. Ishte një digë që sfidonte tufanet. Nuk donte të vonohej në histori. Ishte në Lëvizje dhe, si i tillë, kishte një rreth të gjerë shokësh veprimtarë. Lirinë e Atdheut e donte më tepër se veten. Më mirë të vdes unë se të vdes Atdheu, si thotë me të drejtë rapsodi.[8] Nga 38 vjet të jetës së tij, 20 vjet ishte në shërbim të Atdheut, në shërbim të lirisë, në shërbim të çlirimit dhe bashkimit të kombit shqiptar.

I përjetshëm kujtimi për dëshmorin Gafurr Luma dhe për të gjithë dëshmorët e kombit!

Shaban Çupi, Paldenicë, Hani i Elezit

[8] *Milaim Mezini*



I burgosuri në qeli, grafikë nga ish i burgosuri politik, Sylë Mujaj

Proletarë të të gjitha vendeve dhe popuj të shtypur, bashkohuni!

ZËRI i KOSOVËS

ORGAN I LEVIZJES PER REPUBLIKEN SOCIALISTE SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI • Viti i IV i botimit - Nr.V.1983

VRASJET NEPER BURGJE NUK E MPOSHTIN POPULLIN TONE

Mbas pesë muajsh nga vrasja në burg e Abedin Balës, në burgun e Beogradit u mbyt shoku dhe vëllau ynë i dashur e i paharruar, militanti i Lëvizjes, aktivisti i guximshëm, shpërndarësi e propagandisti i «Zërit të Kosovës», sypatremburi Zijah Shemsiu.

Vrasja e shokut dhe vëllaut tonë të shtrenjtë u përgadit gjatë, që nga muaji e parë të arrestimit, deri kur u likuidua. Fillimisht, Beogradi bëri një propagandë të shfrenuar për të kompremetuar veprën e lavdishme të Zijahut. Gjithë mjetet e informimit, Zijahun me shokë u munduan t'i paraqesin si terrorisë e kriminelë gjoja sikur ata nuk po zgjidhkan metodat e luftës e të punës.«Politika» shkroi fejton. Gjykimi zgjati më tepër se rëndom kur regjimi i dënon patriotët dhe revolucionarët shqiptarë.Pasi menduan se në opinion kishin arritur të krijonin përshtypjen se ai ishte «terrorist» rezonuan se ishte përgatitur mjaft terren për të kaluar në fazën tjetër, për të bërë krimin dhe për të mos u dënuar nga opinioni i brendshëm dhe ai ndërkombëtar pasi bota alergjike ndaj terrorizmit nuk do të reagonte «po ta vrisnin një terrorist». Nga ana tjetër u ndërmorën të gjitha masat që krimi të mbahet në heshtje. Nëse nuk arrihet ky qëllim atëherë vrasja e Zijahut do të paraqitej si vrasje në çast apo vetëvrasje siç gënjyen çetnikët kur vranë Rexhep Malajn, Nuhi Berishën e Bajram Bahtirin.

luftë krejtësisht të pabarabartë ai nuk u thye. Armiku para virtytit të Zijahut përdori armën e vet të fundit dhe më të ligën Vrau shokun dhe vëllaun tonë duarlidhur, vepër mizore që nuk u përmbajt ta kryej si Hitleri në kohën e tij.

ZIJAH SHEMSIU (1950–1985)

Më 4 maj organet e «Z»së famëkeqe ftuan familjen e Zijahut që ta merrnin kufomën. Ai ishte i prerë në fyt me një nga armët e ftohta.

Pushtuesit kryen ceremonitë e veta pavarësisht se nuk kishin kurrfarë efekti.Menjëherë filluan nga mbledhjet në Prishtinë miq të Zijahut, gjithë fshati Përlepnicë të rinj e të reja, pleq, gra e fëmijë, punëtorë e fshatarë e lanë punën dhe dolën ta përcillnin për të fundit herë birin e tyre të dashur, atë që u dha aq shumë atyre, atë që dha jetën në moshën më të mirë për çlirimin e Kosovës.

Xhaxhai i Zijahut i shtyrë në moshë, iu drejtua turmës që ishte mbledhur në varrim, ju drejtua atyre që kishin kaluar fëmijërinë dhe ishin rritur me Zijahun, atyre që kishin ruajtur bagëtinë e që kishin punuar me Zijahun, atyre që zemra u ishte dridhur kur kishin dëgjuar për arrestimin e tij me shokë, ata që e qanin me lot: «A ta bëni hallall Zijahut?» Pyeti, se helbete, djaloshi çapkën dhe i guximshëm në fëmijëri apo rini të hershme sa nuk kishte marrë rrugën e kurbetit ka mundur ta hidhërojë rastësisht dikë nga fshati a rrethina. Pyeti, në prezencë të atyre që ruanin turmën. Ata prisnin përgjegjen se a e aprovon turma e Zijahut apo jo. Nga turma dëgjohet një e thirrur«Lavdi i qoftë». Si një zë i vetëm gjithë turma me pikëllim e krenari thirri pas këtij zëri «Lavdi». «Lavdi» thirri e gjithë Kosova e robëruar, zëri i gjithë masës, zëri i Kosovës, «Zëri i Kosovës» të cilin të hedhur në letër aq shumë e barti Zijahu dhe e shpërndau në qdo anë që të buqasë njësoj në të gjitha trojet e pushtuara nga serbo-maqedono-malazezomëdhenjtë.

Revista ilegale "Zëri i Kosovës", me rastin e vrasjes së Zija Shemsiut në burg në majin e vitit 1985, të cilën e shpërndau Gafurr Luma

Proletarë të të gjitha vendeve dhe popuj të shtypur, bashkohuni!

ZËRI i KOSOVËS

ORGAN I LEVIZJES PER REPUBLIKEN SOCIALISTE SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI • Viti i IV i botimit-Nr. 6. VI.1985

ALEANCE E PATHYESHME QE PO FORCOHET ÇDO DITE

PUNETORE, STUDENTE, FSHATARE, JEMI NJE E TE PANDARE!

Kjo ishte përgjegjia që aleanca e pathyeshme popullore, u dha pushtuesve dhe tradhtarëve në kohën kur po përpiqeshin ta përçanin e ndanin bashkimin luftarak të një populli duarthatë e sypatrembur.

Punëtorët, fshatarët, studentët formuan lëgurën më të fortë që i rezistoi veprimit rrënimtar të pushtuesit. Zëri i tyre u shkri në një, grushtet u shtërnguan fort me njëri-tjetrin. Radhët u ngjeshën dhe si një trup i vetëm u përleshën me policinë dhe ushtrinë e Beogradit. Nga kjo përleshje gjaku i tyre i kuq, si flamuri kombëtar e proletar vërshoi rrugëve dhe për Republikë u bë një.

Këto rrëke gjaku, nga një anë, përgjithnjë ndanë popullin nga i huaji dhe tradhtarët, ndërsa në anën tjetër si gjak hoqi çdo iluzion dhe u bë simbol i një bashkimi të përjetshëm. Me këtë gjak të derdhur bashkarishi u shkruz parulla famëmadhe PUNETORE, STUDENTE, FSHATARE — JEMI NJE E TE PANDARE! Kjo parullë u thirrë në kohën kur pushtuesit me demagogji përhapnin në popull ideinë se demonstratat nuk përkrahesh nga klasa punëtore, në kohën kur bëheshin përpjekjet për t'i ndarë studentët e për t'i mashtruar si më 26 mars; në kohën kur me shpejtësi rrufeje demonstruesit e kuptuan se vetëm duke qenë të bashkuar klasa punëtore me fshatarësinë dhe inteligjencien revolucionare do të mund t'i rezistojë ripushtimit të Kosovës. Eshtë kjo parullë që shprehë depërtimin e elementit të ndërgjegjshëm në masat e gjëra, parullë që do të vije duke u fuqizuar dhe rugitur aktualitetin.

Sot, pas katër viteve, pas kaq ngjarjeve megjithë që manifestimet e përbashkëta rrugëve u ndalën, u shtypën me gjak nga pushtuesi nuk ka forcë që mund ta shlyejë nga ndërgjegjia këtë bashkim luftarak, këtë mirëkuptim, lidhjet që u krijuan në mes këtyre aleatëve të natyrshëm në luftën për Republikë. Pas demonstratave heroike, në kushtet e një terrori të paparë çetnikë, eci nga këta tre aleatë, po vazhdon luftën për realizimin e kërkesave që bënë së bashku. Ata po vazhdojnë luftën hapur dhe mbyllur, gjithëherë duke synuar që të thejnë pengesat që ka vënë armiku që përsëri të bashkohen, krah për krah dhe si një grusht i vetëm përsëri të marshojnë shesheve të qyteteve e të fshatrave të Kosovës.

reja më luftarake. Kohët e fundit, Kosovën e përfshiu një valë e fuqishme grevash proteste. Valë zemërimi shpërtheu edhe në Fabrikën e Vajit në Ferizaj,shkak i mugesës së lëndës së parë e cila shkoi deri në atë pikë sa punëtorët të dërgohen në pushim të dhunshëm. Revoltë e ligishme po zien edhe në Kombinatin «Tefik Çanga»

Punëtorë, studentë e fshatarë, jemi një e të pandarë! Një material tjetër ilegal që e shpërndau Gafurr Luma

LIRIA

ORGAN I MARKSISTË-LENINISTËVE TË KOSOVËS

"L I R I A"

Gazeta ilegale „Liria" e vitit 1980 e ruajtur për 38 vite me radhë nga bashkëveprimtari Nevait Luma, si material ilegal i dëshmorit Gafurr Luma .



Përpara drejt fitores! [9]

[9] *Grafika është marrë nga revista ilegale "Zëri i Kosovës". Autor është Emrush Xhemajli*

1.
Me një çantë në dorë
E në kokë një plis,
Niset biri i shqipes
Shtigjeve të lirisë.

Çantën mbushur plot
Me libra, fletore
Abetarja e shtrenjtë
Dheshkronja kombëtare.

Niset si zog mali
Nga bregu në breg,
Në kërkim të dritës
T`i shpërndajë rrufetë.

Me hapa pionieri
Me gëzimin në gji,
Niset Gafurr trimi
Bashkë me shokë të tij.

Niset për shkollë fillore
Te mësuesi Musli,
Mësojnë shkronjën A
Të shtrenjtën Liri.

Kalon nga një shkronjë
Te një shkronjë tjetër,
Të lind një botë e re
Ta përmbysë të vjetrën.

Me plisin në kokë
Me libra, fletore,
Udhëton voci i vogël
Drejt shkollës fillore.

Si bleta mbi lule
Merr nektar të dritës,
Nëpër mësime, lojëra
Kalitë shtatin e rritës.

Nga shkolla në fushë
Nga fusha në mal,
Me fyellin e gjatë
Gurë mbi gurë me strall.

Nga Livadhi i Lleshit
Te Qafa e Kalasë,
Nga Laki i Zanogës
Në Kepin e Shkallës.

Me këngën e Mujës
Talin e Budalinës,
Arrnaut Osmanin
Këngën e gjeraqinës.

Rritej voci i vogël
Me bulëza në faqe
Ngjitet në ahishte
Dhe mbledhë manushaqe.

Në grunaja, elbore
Në kala e shpella,
Balada e rrëfime
Ku fshihej e vërteta.

Vështron Sharrin plak
Borën sikur plis,
Në dallgë e furtuna
Për ku trim je nis?

2.
Nëpër rrugë të dritës
Udhëve të Atdheut,
Nip i Naim Frashërit
Stërnip i Skënderbeut.

Me fjalët e qiririt,
Kushtrimin migjenian,
Bagëtinë e bujqësinë
Malin që s`bëzanë.

Kalon fusha, male
Bie n'Kaçanik,
Çantën hedhur në shpinë
Librin shok e mik.

I afrohet Kalasë
E vjetër, sa shekuj,
E prek gurëballorin
Në luftë me kulçedrën.

Kalon derën hyrëse
E pushton brendinë
Ecë mbi mur t'qëndresës
Murit të lashtësisë.

Ecë si Vrana Konti
Si i forti Moisi,
Sa balada u thurën
Për Shqipëri!

Kalon nga një skaj
Shkon në skajin tjetër,
Prek me duar të dlirëta
Kalanë e mesjetës.

Si shqiponjë e Sharrit
N`Gur të Shpum, vështron
Aty ku Idriz Seferi
Luftoi me osmanë.

Aty ku kali i tij
Notonte në gjakë
Aty ku shqipot trima
Po nxirrnin hak.

Aty u thye pushtuesi
Aty u bë gjama,
Në Grykë të Kaçanikut
Luftë me pushkë e kama.

Aty ku Gryka
U bë varr pushtuesi,
Ecte Gafurr Luma
Zemrën sikur prushi.

I bie Neredimes
Degës për Egje,
Sa freski i solli
Të bukurit Atdhe.

Me lumin kristal
Që vinte nga Lypeteni,
Bashkohej me Neredimen
Dhe rritej Lypeni.*10

Me çantën në shpinë
Mbushur libra plot,
Ecte Urës Konakut
Takon miq e shokë.

Në mesin e Çarshisë
Përballet me viganin,
Takon Sali Bajrën
Që ia kishte ndi' zërin.

Tungjatjeta Bac,
Sa malet me kreshta,
Vij nga Qafa e Shqipes
Rrofsh sa të jetë jeta!

Je nderi i kombit
Kështu të thotë vegjëlia,
Unë jam Gafurr Luma
Vij nga shkrepat e mia.

Vij nga majat e Sharrit
Zbrita n`Kaçanik,
Kërkoj dritë të diellit
Kërkoj shokë e miq.

Erdha në shkollë të mesme
Me bukën e gojës,
Rreth e çark i rashë
Edhe ”Voskopojës”.

E kalova çarshinë
Shtruar me kalldrëm,
Eca përmes qytetit
Në të bukurin vend.

Me “Lulet e Verës”
N’kala të Rozafës,
Me Mitrush Kutelin
Me vargjet e Qemal Stafës.

Me Lulin e Vocërr
A do qymyr, zotni,
I kam mësuar n’fillore
Nga mësuesi Musli.

Me "Lugjet e Verdha"
Shpellën me piratë,
Me këngën e shqiptarit
Me sharrën në krahë.

Shtegton Gafurr Luma
Shpirtin plot zjarrmi
Ngjitet valëve të jetës
Për dritë e liri.
3.
Kënga e pranverës
Jehonte në rrëzë të Sharrit,
Çelnin lulevjollcat
Rreth lisave të ahut.

Baba në minierë
Thellë në galeri,
Nxirrte nga nëntoka
Bukën për fëmijë.

Bukë e xehe bashkë
Djersë edhe trishtim,
Që t`i rriste fëmijët
T'u jipte shkollim.

Nëna Zylë n'oxhak
Bukënoren në flakë,
Që t`i ngopte fëmijët
Me barkun e zbraztë.

Ulur përreth sofrës
Rriteshin vëllezër e motra,
Aty rrënjës Sharrit
E ngrohtë bëhej votra.

Kështu ata kalonin,
Pranverë e verë,
Vjeshtë e dimër,
Me ujq e skifter.

Ujku ua merrte
Shpesh delen në vath
Skifteri grabiste pulat,
Pulat bashkë me zogjë.

Kështu kalohej jeta
Me ujqër e arinjë,
Me dhelpra, me korba
Dhe me smirëzinjë.

Mësohej historia
Nga brezi në brez,
Për trimat e tokës
Flitej vesh më vesh.

Rrëfenin për një trim
Arif Dragomacin,
Për Xhelë Kalishtën
E Xhemë Gostivarin.

Flitej për Avdyl Durën
Edhe për Ramë Bekën,
Kur do t'jetë e mundur
Ta lajmë amanetin?

Flisnin për kaçakët
Që kishin dalë malit
Kundër të gjithë armiqëve
Që kishin zënë vatanin.

Shpalosej historia
E larë prore me gjak,
Sa andej, në Drenicë
Sa në Karadak.

Në Pollog luftohej
Me komita t'Bugarit,
Kurse në Grykë të Lumës
Me askera të kralit.

Kështu për çdo natë
Kur bora zinte shtigjet,
Shpalosej historia
Që nuk shkruhej në libër.

4.
Kur vinte vera
Dielli digjte flakë,
Nisej majes malit
N`Lypetenin e lartë.

Ngjitej shpatit të malit
Si në Baba Tomor
Kur nuk kishte shi
E kur s`kishte borë.

Ulej në maje të majës
Si shqiponjë mbi shkëmb,
Një vështrim n'Korab
E tjetrin në Tanushë.

Vështronte Kosovën
Moravë e Dukagjin,
Shkupin e Tetovën
Me shumë mallëngjim.

Vështronte Kalanë
E Shkupit historik,
Kërkonte Tiranën
Detin Adriatik.

Pse vallë ky fat
I ndanë vëllain me vëlla,
Njëri në Maqedoni
E tjetri nën shkja?

Njëri mbet me grekët
Tjetri me Mal të Zi,
Me kufinj të fortë
Ndanë këtë Shqipëri.

Pse more, kështu,
Të ndarë copa-copa,
Pse kjo tokë u përflak
Me pushkë e me topa?

Pyeste Gafurr Luma
Në majë të Lypetenit,
Kur vrojtonte andej
Nga maja e Shkëlzenit.

Heshti Drini i Zi
Bashkë me Dri të Bardhë,
Heshti lumi Ibër
Dhe lumi Moravë.

Gjergj Elez Aliu
Që moti kish ndërruar jetë
Shumë bajloz të tjerë
Kishin marrur fletë.

Që nga Shën-Stefani
N'Kongres në Berlin,
Toka e shqipeve
Ish bërë copë e grimë.

E kishin ndarë me pash
Apo me dynym,
Fqinjët grabitçarë
Erdhën me pushtim.
5.
Ecte Gafurr Luma
Nëpër monopate,
Të veprohej ishte
Ecje në teh shpate.

Sa shumë e donte
Lëndën e gjeografisë,
Në gjimnazin "Skënderbeu"
Kur mësonte Shqipërinë.

Pse kaq të ngushta
Rrobat na janë pre,
Pse nga shumë kufinj
Jemi të ndarë ne?

Qeshte profesori
Buzëqeshte kur fliste,
Kështu na i prenë rrobat
Më t'mira nuk kishte!

Pse, pse e pse,
Por përgjigje s`kish
Derisa një ditë
E takoi një "këlysh".

Ç`të duhen këto pyetje
I mjeri sharrjan
Kosova është e lidhur
Fort me Beligrad?

Me shokun Tito
Me bashkim-vëllazërim
Me heronjtë tanë
Që luftuan për çlirim.

Kështu klithte ky këlysh
Qen i Rankoviqit
Dhe të gjithë i druheshin
Si mizat prej bishtit.

Ky këlysh i pistë
Me emrin Murrash
Gjithandej flitej
Se rri me udbash.

Nga një vit kalonte
Në një vit tjetër,
Bashkë me shokë e shoqe
Nëpër valë jete.

Lexonte një libër
Një roman të ri,
Shkonte duar më duar
Dhe ruhej në gji.

E ruanin në gji
Të mos e sheh Murrashi,
Dhe shpesh thërrisnin
Ikni se po vjen udbashi.

Nga "Hasta la vista"
Te "Gremina e dashurisë",
Nga "Lulja e kujtimit"
Te "Çeta e Dangëllisë".

Nga romani ,,Zgjimi''
Te "Pishtarët e lirisë"
Nga "Besa e Resul Çelimarës"
Te "Histori e Shqipërisë".

Nga "Garda Krutane"
Te "Prijësja e komitëve",
Nga "Shqipja e kreshtave tona"
Te "Shembja e idhujve".

Lexuan libra
Të Bajramit në Dragobi,
Syrgjin gjallë e syrgjyn vdekur
Këndojnë këngë me çifteli.

Lexuan Pashko Vasën
Për të mjerën Shqipni,
Edhe Sami Frashërin
Librin me gjarpinjë.

Mësuan historinë
Lidhjen në Prizren,
Mësuan Abdyl Frashërin
Të madhin Kuvend.

"Epokën para gjyqit"
Në njëqind vjetor,
Sa popull i mirë jemi
Sa armiq mizorë!

Ecte Gafurr Luma
Me libra në gji,
Gjithnjë thoshte me vete
E shtrenjta liri!

E shtrenjtë je liri
S`ka si ti në botë,
Gjersa një ditë gjeti
Ilegalin Agron.*11

U përqafuan fort
Si vëllai me vëlla,
Aty lidhën besën
Të luftojnë me shka.

Fort e lidhën besën
Aty nga Kalaja,
Lart i ngritën grushtat
Me armikun - belaja.

Tani Gafurr Luma
Mori emër të ri,
Agim*12 tani quhej
Në luftën për liri.

Agroni e Agimi
Ngritën një celulë,
Filluan të lexojnë libra
Që s'i kishin parë kurrë.

Ju erdhi "Liria"'
E kuqe me bajrak,
"Këngët e lirisë"
Erdhi dhe një trakt.

Trakti "Liria"
Në luftë për atdhe,
Grushtin të bashkuar
Shqiptarë jemi ne!

Poshtë robëria,
Poshtë Tito satrapi,
Poshtë shtypja,
Liri kërkon shqiptari!

Të ngritemi vëllezër
Të ngritemi motra,
N`këmbë i madh e i vogël
Të mos na fiket votra.*[13]

Gjithnjë e më shumë
Trakte e parulla,
Shpërndaheshin fshehurazi
Sa hall kishte UDB-a.

Qëndisej flamuri,
Flamuri me shqiponjë,
Ngrihej në qytete
Dhe mbahej në dorë.

Marsi sjell pranverën
Pushka sjell lirinë,
Buqiste Prishtina
Duam Republikë!

Buqiste Prishtina
Konviktet me studentë,
Është atdheu ynë,
Është i bukuri vend!

Rroftë Kosova,
Rroftë Republika,
Trepça është e jona
Përpara djemë e qika!

Përpara vëllezër, motra
Kosova-Republikë,
Grushtin të bashkuar
I thonë armikut, ik!

Republikë - Kushtetutë,
O me hatër, o me luftë,
Republikë - Kushtetutë,
O me hatër, o me luftë!

Grushtin ngritur lart
Me shokë n'demonstrata
Qëndronte Gafurr Luma
Nëpër barrikada.

Në dy anët e barrikadës
Grushti e bajoneta,
Në njërën anë yje
Në tjetrën helmeta.*[14]

Breshër bombash hidhte
Milicia "speciale",
Me gjokset e shpalosura
Hidhet djalëria kosovare. *15

Armë, çelik e dimë që keni
Ju ujqër t'Serbisë,
Por ne veshur kemi lindur
Me xhamadana të trimërisë.*16

Të shtrënguar fort
Grushtin në bajonetë
U gjakos Prishtina
Nga serbomëdhenjtë.

U gjakos Prishtina
Llapi me Dukagjin,
Burgosej rinia
N'Ferizaj e Kaçanik.

U burgos Agroni*[17]
U burgos dhe Shpendi*[18]
U burgos Bardhyli *[19]
Edhe Hysë Derveni.*[20]

U burgosën me mijëra
Burgjet u mbushën plot,
U prangua Gafurri
Djali zemërzjarrtë.

E mbyllën në qeli
Si zogun n'kuvli,
Vetëm pse kërkoi
Të shtrenjtën liri.

Tak-tak, tak-tak-tak
Të trokitura në mur,
Mbahu i fortë, vëlla
I fortë mbahu, o burrë!*[21]

Një zë i ngrohtë
I ëmbël sa s`ka,
Qëndro, o shok
Mbahu, or vëlla! *22

Edhe trupin e dërmuar
Copë-copë t`na e bëjnë me thikë
Në zemrat tona e kemi shkruar
Rroftë Kosova-Republikë!*23

E dënuan shumë vite
Në terrin e qelisë,
Por ai kurr si ndali
Këngët e lirisë.

Ballë për ballë me shtypës
Tradhtarë e udbash,
Qëndronte Gafurr trimi
Si lis në malin Sharr.

Trego për Ramizin *24
Bujarin,* 25 Kujtimin *26
Trego për Demën *27
Edhe për Kushtrimin!*28

Trego për Shkëmbin, *29 Metin*30
Për Shpendin,*31 Gjin Bua Shpatën *32
Materialet ku i ke lënë,
Nga kush i more traktet!
6
Atë vit kishte marrë
Dimër i vështirë,
Nën borë e acar
Gjithçka kishte ngrirë.*33

Niset nëna Zylë
Me çantën në krah,
Nëpër burgje të birin
Duhet për ta parë.

Hapej një dritare
E mbërthyer në grila,
Kërkoj Gafurr Lumën
U thoshte Nënë Zyla.

Pse djalin e ke në burg,
A ka vra njeri?
Jo, tha nënë Zyla
Në burg është për liri.

Mbyllet me rrëmbim
Dritarja e zandanit,
Kërkëllijnë fort hekurat
Në burgje të dushmanit.

Nëna Zylë po pret
Bashkë me djalë Eminin,
Derisa të hapet dera
Ta shoh Gafurr trimin.

Kërcisnin shulat
Se u hap një derë,
Doli Gafurr Luma
I buzëqeshur përherë.

Nënën ta përqafoj, deshi
Por grilat ishin në mes,
Si je më shëndet nënë
Të paça të fortë përjetë!

Deshi t`ia ledhatojë
Rrudhat në ballë,
Me e prekë nënën,
Grilat nuk e lanë.

A ka rënë borë
Te ne, në malësi,
Akull e acar, a mbanë
A ka ujqër të zi?

Plaku të çon të fala
Motrat t'përqafojnë,
Kalon edhe kjo zezonë
Të ndihmoftë i madhi Zot!

Kështu i tha nënë Zyla
Me rrotulla nisi të flas
Një gardian dëgjonte
Edhe një udbash.

Ta kam prue jelekun
Të thurrur me krrabëza,
Një palë çorapë leshi
Dhe shokën lara-lara.

Dimri do t'kaloj, nënë
Pranvera do të vijë,
Bashkë me pranverën vjen
E shtrenjta liri.

Ulurijnë udbashët
Seç u bë shamata,
U ndërpre vizita
Gafurri u lidh n'pranga.

E përplasën trimin
Sërish në qeli,
Në beton të akullt
Si zogun n'kuvli.

Trupin e shkallmuar
Në tortura të mizorit,
Ashtu e zuri nata,
Natë e dhjetorit.

Seç i iku mendja
Kalojë grila, hekura,
Shumë i dhimbsej nëna
E përballur me të zeza.

Fliste nga largësia
Me motrat e tij,
Shumë i donte vëllezërit
Atë Qaniun e ri.

Ashtu si në mjegull
Ashtu, në kllapi
Fluturonte qiellit
Për të shkuar n'shpi.

Kalon nëpër Sharr
Si në fluturim,
Nuk ka si Kosova
Si Atdheu im.

Një rrapëllimë e madhe
Ia këputi ëndrrën
E kthyen njërin në qeli
Ia kishin bërë gjamën.

Tak-tak, tak-tak-tak
Gafurri i bie murit,
Qëndro shok e vëlla
Mos iu dorëzo pushtuesit!

7.
Mbi Kosovën trime
Nata kishte pllakosur,
Bie shi pa ndalë
Acari s`kishte të sosur.*[34]
8.
Kështu kalonin javët
Kalonin muaj e vite,
Një ditë doli nga burgu,
Doli si zog shqipe.

U gëzua me nënën
Me babën në shtrat,
I përqafoi motrat
E vëllezërit njomak.

E kishte marrë malli
Për gurët e votrës,
E kishte marrë malli
Për vëllezër, për motrat.

9
Mall Kosove, kishte
Populli në demonstrata
Grusht të bashkuar
Përballë në barrikada.

Jo, jo, Serbi,
S`do të jesh perandori!
Kurrë nuk do të ndalemi
Në luftë për liri!

Studenti në rrugë
Minatori në galeri
Grushtin ngritur lartë
Për të drejta e barazi.

Kështu ishte 89-ta
Po kështu edhe e 90-ta
Kosova Republikë!
Kjo ishte e vërteta.

Rritej rezistenca
Flakë nxjerrte maliheri
Ra për t`mos vdekur kurrë,
Dëshmor Ali Ajeti.

Ra Afrim Zhitia
Përballë me dushmanin
Ra Fahri Fazliu
Për liri t`vatanit.

Gjak dëshmori biente
Mbi tokën dardane
Mbinin lulëbozhuret
Më të bukurat e kësaj ane.

10
Nisë një epokë e re
U shemb Muri i Berlinit,
Liria e popujve,
Shpresa prej perëndimit.

Fryejnë erëra të reja
Ato Evropiane,
Nisi të shpartallohej
Jugosllavia avnojane.

Fryenin erëra të reja,
Ato të demokracisë
Por Kosova trime
Nën kthetra të Serbisë.

U mbyllën shkollat
Punëtorët - pa punë,
Po shtrohej zullumi
Natën s`bëhej gjumë.

11
Në korrik 92
Mblodhi shokë e miq,
U martua Gafurri
U gëzuan farë e fis.

Me def këndojnë motrat
Urojnë çiftin e ri,
Jetë të lumtur paçit
Nuse e dhëndër i ri!

Hydajetja nuse
Lulja e vatanit,
Krahë për krah me Gafurrin
Si shqiponjë e malit.

Mirësevjen, moj nuse
Me plot bukuri,
Bashkë me Gafurrin
Në luftë për liri.

U gëzua shtëpia
Lumja nënë u gëzua,
U gëzuan dhe motrat
Që martuan vëllanë.

Bëri dasëm të madhe
Mblodhi miq e shokë,
Por Atdheu rënkonte
Kush t`i dilte zot!

U gëzua familja
U gëzua dhe trimi,
Kur i lindi djali
Kur lindi Lirimi.

Gëzimi u shtua
Kur lindi Kaltrina,
Vajza më e bukur
M'u si gjeraqina.

Kështu kalonin muaj
Kalonin dhe vite
Pranverë e verë
Vjeshtë, acar e dimër.

Erërat europiane
I ngacmonte veriu
Ballkani në tym
Terror bënte Sllobziu.

Një natë dimri
Acari bënte shamatë
Erdhën te Gafurri
Mysafirë të largët.

Erdhën Xheladini*[35]
Bislimi, Naiti
Të kërkojmë ndihmë,
Gafurr, kryengritësi!

Liria do armë
Pushkë e maliher
Ta shpëtojmë Kosovën
E zhytur në terr.

Liria do armë
Top e municion,
Drenica hallemadhe
Kryengritëse gjithmonë.

U ngritën grushtat lart
Dhe u dha betimi,
Përherë jam i gatshëm
U tha Gafurr trimi.

Ecte Gafurr Luma
I heshtur si gjithmonë,
Takoi Rexhep Bislimin*[36]
Një natë, natën vonë.

Kështu gatuhej lufta
Lufta për liri,
Por në një mëngjes
Erdhën korbat e zi.

E rrethuan herët
Në lagje e shtëpi,
E lidhën në pranga
E kthyen në qeli.

I bënë shumë tortura
Me rrymë, me kërbaq
T`ia ndalnin rrugën
Çetnikët smiraq.

E shtrinë në tortura
Mizorët e Serbisë,
Duan ta zhdukin Kosovën
Zemrën e Shqipërisë.

E mbyllën në qeli
Si zogun n'kuvli,
Vetëm pse e donte
Të shtrenjtën liri.

Brenda mureve me beton
Gafurri gjen frymëzimin,
Kjo është rruga e lirisë,
Kështu na vjen shpëtimi!

12
Kosova dardane
Goditej me topa,
Ta zhdukte nga toka
Ai kriminel Slloba.

Sulmoheshin kullat
Digjeshin shtëpitë,
Vriteshin pleqtë
Po edhe fëmijët.

Terr e zi n'Kosovë,
Gjëmon toka ilire,
Bisha po sulmonte,
Pa kurrfarë mëshire.

Endeshin njerëzit
Nga mali në mal,
Gra e fëmijë në vaj
Të bërë refugjatë.

Iknin nga atdheu
T'përzënë nga vatani,
Shkrumbohej Kosova,
Luftonte shqiptari.

Kështu vepronte demoni
Me ushtrinë e tij,
Hapeshin varre
Bëhej mizori.

Përballë mizerjes
Ushtarët e lirisë,
Bijtë e Adem Jasharit
Shqiponjat e trimërisë.

Njësitë çlirimtare
Me emblemë në krah,
Binin dëshmorë
Lufta ballë për ballë.

Gjëmonte Drenica
Luftonte Dukagjini,
Llapi me Gallapin
Kosharja e Pashtriku.

Luftonte Shala
Bashkë me Neredime
Me pushkë e topa
Kosova martire.

Ra Agim Bajrami
Agim i lirisë,
Besniku, Xheladini
Luftëtarë të lirisë.

Mbushej tokë e arbërit
Me shumë katakombe,
Mbushej me dëshmorë
Kosova vigane.

UÇK-ja me flamur
Për ne dritë e shpresë
Komandant Adem Jashari,
Liri, që nuk vdes.
13
Seç dridhej Gryka
Në luftë çlirimtare
Lufton UÇK-ja
Me bishat barbare.

Grykë e Kaçanikut
Derë e stuhive
Grykë legjendare
Varr i perandorive.*[37]

Në gjoksin tënd të gurtë
Fole e trimërisë
Nuk u shua kurrë
Zjarri i lirisë.*[38]

Me këtë zjarr lirie
Lufton Qani Luma
Ballë për ballë me hasmin
Marshon në fortuna.

Në luftë për liri
Lulja e vatanit.
Ushtar i Brigadës
Së Agim Bajramit.

Bashkë me Osman Lumën
Lart e ngritën zërin,
I skuqin maliherët
Në luftë me dushmanin.

Në rrëzën e Sharrit
Përballë me çetnikë,
Qëndron Qani Luma
Lufton si kreshnik.

Dridhej automati
Flakëron si rrufe,
Me gjak të kuq ujiti
Të dashurin Atdhe.

Pushka e Qaniut
Jehon në veshë t'Gafurrit,
Të paça vëllai im,
Shqipe në mes t'flamurit!

Shqipe e flamurit,
Flatrat e shqiponjës,
Hallall gjaku i qoftë
Lirisë së Kosovës!

Emri yt, Qani
U bëftë dritë e jetë,
Rroftë Kosova e lirë,
Shqipëria e shenjtë!

14
Brenda në qeli
Lidhur me zingjirë,
Qëndron Gafurr Luma
Për ditë më të mirë.

Për një ditë të mirë
Për një Shqipëri,
Ia thotë një kënge
Që i vlonte në gji.

Nis një këngë të vjetër
E mësoi n'burg të parë,
E këndonte përherë
Kur kishte shumë mallë.

Unë nuk ndjej vetmi
Në terrin e qelisë,
Mua më shoqërojnë
Këngët e lirisë.*39

S`më mposhtin torturat,
Armiqë e tradhtarë,
Luftëtar lirie, jam,
Revolucionar.*40

Nuk përulem kurrë
Para pranoj t'vdes,
Shokët nuk i jap
Atdheun nuk e shes.*41

Njëmijë herë po t'bie
Do t'ngritem përsëri,
Sërish do t'hidhem
Në luftë për liri.*42

Kështu këndon Gafurri
Në qeli t`armikut
Aty ku si dridhej
As maja e çerpikut.

Nga qelia me hekura
Mendja i shkon në Prishtinë
Kur populli brohoriste
Duam Pavarësinë!

I kujtohet pranvera
E gjakosur në flakë
I kujtohet rinia
Ballëhapur n`demonstratë.

Kam parë birin e Kosovës
Tankut para si i doli,
Para grykës hapi gjoksin,
Sokëllinë si Mic Sokoli.*[43]

Kam parë djemtë e Kosovës
Si nga sytë nxirrnin shkëndija,
Vërsulen mbi mitraloza
Si dikur Selam Salaria.*[44]

Kam parë vajzat e Kosovës
Kam parë nëna shamizeza,
Qëndronin përballë dushmanit
Si Shotë Galica e Mine Peza.*[45]

Kam parë e çka s`kam parë
Fliste me vehten Gafurri
Dhe mendja i iku në amshim,
Trupi shtizë flamuri.

Kudo që t'vdes, moj nënë
Dua trupin të ma kërkosh,
Dua lot të mos derdhësh
Me flamur kur t`më mbulosh.*46

Kur flamuri t'më mbuloj,
Ti mos qajë, moj nëna ime,
I qetë në varrë unë do të pushoj,
Se kam rënë për tokën time.*47

Në mos ardhsha kurrqysh ndryshe
Do të vij një ditë në bust,
Do të jem ashtu, si isha
Sytë plot mall e dorën grusht.*48

Dëshmori Gafurr Luma, i kthyer në bronz



15
Fluturon Nënshqiponja
Në homazhe për dëshmorë
Bie në Fushë t`Pajtimit
Ku prehen, më të shtrejtit tanë.

Nderon komandant ,,Zefin",
Agimin e lirisë
I përjetshëm qoftë kujtimi
Pushka e Shqipërisë!

Nderon komandant ,,Bardhin",
Gjithë dëshmorët e tjerë
I përjetshëm qoftë kujtimi
Rënia juaj me nder!

Udhëton Nënëshqiponja
Nga varri në varr
Nderon vëllezërit Luma
T`pavdekshmit çlirimtarë.

I shpalos flatrat
Shqipja e Shipnis,
Përherë u kujtofshi
N`anale të historisë!

Nderon gjithë dëshmorët
Me nderë e respekt,
Pushka juaj çlirimtare
Për ne, dritë e jetë!

Ngritet lartë në qiell
Shqipja e Shipnis
Fluturon bjeshkëve të Sharrit,
Kështjella të lirisë.

Kreshtave të këtij vendi,
Bie në ,,Rambuje"
Nderon Kaçanikun
Të bukurin atdhe.

Kalon nga një fshat
Në një qytet tjetër
Nderon liridashësit
Lulet e atdheut.

Shpejton fluturimin
Në Llap e Dukagjin
Ulet në Prekaz
Plot me mallëngjim.

Përkulet tek varri
I Adem Legjendarit
Nderon heroizmin:
Shaban e Hamzë Jasharit.

Vepra juaj, dëshmorë
Flakadan lirie
Mbetët yje të pashuar
Të Kosovës martire.

PASTHËNIE

...dhe, kështu edhe ndodhi. Në prill të vitit 1999 forcat pushtuese serbe, Gafurr Lumën e nxorën nga Burgu i Gjilanit, ku po mbahej nga 10 gushti i vitit 1998 dhe e transferojnë në burgun famëkeq të Dubravës. Më 22 maj 1999 e vranë bashkë me shumë shokë të tjerë në orët e hershme të mëngjesit. Trupin e tij të pajetë familja e gjeti pas përfundimit të luftës në varreza në fshatin Rakosh, komuna e Burimit (Istog).
Bashkë me trupin e pajetë të Gafurrit, në varrezat masive të Rakoshit u gjetën edhe trupat e dëshmorëve nga komunat e tjera si dhe nga komuna e Kaçanikut: Mejdi Dalloshi, Tefik Raka, Danush Kurtaj dhe Suad Brava nga Hani i Elezit

Gafurr Luma u rivarros me nderime të larta kombëtare në Varrezat e Dëshmorëve bashkë me vëllain e tij, Qaniun, i cili ka rënë Dëshmor më 8 mars 1999 në malet e Sharrit, gjatë betejës me forcat serbe, si ushtar i Brigadës 162 "Agim Bajrami" të UÇK-së.

Ashtu, siç e thotë edhe poezia, Gafurr Luma u kthye në bust, si Dëshmor i Kombit, m'u aty, në oborrin e shkollës, e cila sot mbartë me krenari emrin e tij.

Fusnotat të përdorura në tekst:

*10Lumi Lepenc
*11Pseudonim i Ferid Qallakut
*12Pseudonimi i Gafurr Lumës gjatë veprimtarisë ilegale
*13 Këngët e lirisë, 1980
*14Revista ilegale "Liria", 1981
*15Po aty
*16Po aty
*17Pseudonim i Ferid Qallakut
*18Pseudonim i Berat Luzhës
*19Pseudonim i Kadri Luzhës
*20Pseudonim i Hydajet Hysenit
*21Marrë nga poezia e Hydajet Hysenit "Trokitje në mur"
*22Po aty
*23Poezi nga shtypi ilegal
*24Pseudonim i Remzi Elezit
*25Pseudonim i Bajram Dernjanit

*[26]Pseudonim i Shaban Çupit
*[27]Pseudonim i Remzi Krrabës
*[28]Pseudonim i Kadri Rakës
*[29]Pseudonim i Ismail Malësiut
*[30]Pseudonim i Mefail Vishit
*[31]Pseudonim i Emrush Tafilit
*[32]Pseudonim i Muhamet Qorrit
*[33]Strofë nga poema "Pushka amanet" e Hydajet Hysenit
*[34],,Këngët e lirisë'' 1980
*[35]Xheladin Gashi, Bislim Zogaj, Nait Hasani, anëtarë të Shtabit të Përgji-thshëm të UÇK-së
*[36]Dëshmori Rexhep Bislimi
*[37]Poezi nga Ferid Qallaku, botuar në "Këngët e lirisë", 1980
*[38]Po aty
*[39]Poezi e botuar në përmbledhjen me poezi "Këngët e lirisë", 1980
*[40]Po aty

*[41]Po aty
*[42]Poezi e botuar në "Këngët e lirisë",1980
*[43],,Liria'' nr.4-5, gusht 1981
*[44]Po aty
*[45]Po aty
*[46]Po aty
*[47]Poezi nga revista ilegale "Liria", nr.6, dhjetor 1981
*[48]Sipas poezisë së Hydajet Hysenit "Strall Kosove"

Shënime për autorin

Shaban Çupi është i lindur në vitin 1961 në fshatin Paldenicë, komuna e Hanit të Elezit. Ka të kryer Fakultetin e Edukimit dhe në arsim punon nga viti 1980. Është dy herë i burgosur politik dhe ka mbajtur 6 vite burg. Është përjetues i masakrës në burgun e Dubravës në majin e vitit 1999, bashkë me dëshmorin Gafurr Luma. Ka qëndruar në këto burgje: Gjilan, Prishtinë, Lypjan, Gurakoc, Dubravë dhe Nish.

Deri më tani ka botuar këto libra:
1.*Nga gjaku i tyre rrjedh liria*, poemë
2.*Gafurr Loku 1949-1999*
3.*Shënime në kohë të mugëllt*
4.*SHKA„Sharri" në Han të Elezit*
5.*Jatakët e lirisë*
6.*Gjurmime etnografike në trevën e Hanit të Elezit*
7.*Shkolla popullore shqiptare në fshatin Paldenicë,* me bashkautor
8.*Trashëgimia kulturore në trevën e Hanit të Elezit* me bashkautor
9.*Historiku i xhamive dhe shkrimet mbivarrore në trevën e Hanit të Elezit*
10. *Gafurr Loku në kthetrat e UDB-së*
11. *Buzëqeshje lirie*, poemë kushtuar dëshmorit Gafurr Luma